



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1005/1 prot.

Tiranë, më 25. 09. 2023

V E N D I M

Nr. 188, datë 25. 09. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 168 Regj., datë 14.09.2023, të shtetasit J. Z., kundër Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik të Bashkisë Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të *gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, gjendjes shoqërore, moshës, gjendjes shëndetësore dhe çdo shkak tjetër*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues, J. Z., ka shpjeguar se ka filluar punë në Bashkinë Tiranë, nëpërmjet kontratës individuale të punës, të datës 04.03.2013, e cila ka përfunduar për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, në muajin Korrik 2021.

Sipas tij, ka ka punuar pranë Bashkisë Tiranë rreth 8 vite, në Ndërmarrjen nr. 2, të saj. Gjashtë muajt e parë ka punuar tek Brigada e Asfaltimit dhe ka qenë me organikë po aty. Pjesa tjetër ka punuar roje.

Emërimi i tij ka qenë te Brigada e Zgarave, kurse praktikisht ka punuar Roje Parku, të makinave të ndërmarrjes, me orar një ditë 17 orë, një ditë pushim. Kjo pa ndërprerje për çdo ditë të rreth 8 viteve, nga ora 14:00 – 07:00 të ditës tjetër në mëngjes.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Ankuesi referon se nuk ka marrë leje të zakonshme asnjëherë, nuk ka bërë asnjë ditë pushimi, (qoftë të shtunë të diel, apo festa zyrtare) dhe për këto nuk është paguar, në asnjë prej viteve që ka punuar pranë këtij punëdhënësi.

Një cikël pune i kryer nga J. Z., sipas tij, ka qenë p.sh.: fillonte punën në orën 14:00 të datës 01.01.2021, deri në orë 07:00 të datës 02.01.2021, që i bie 17 orë punë pa ndërprerje. Në vijim, fillonte punën në orën 14:00 të datës 03.01.2021, deri në orën 07:00 të datës 04.01.2021. Pra, sipas tij, pushimi nga turni në turn ka qenë 31 orë. Ky cikël ka vazhduar për rreth 8 vjet.

Ankuesi thekson se, mënyra e shërbimit të rojës/punës të tij, si dhe kolegëve, pasqyrohej në librat e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit, me shkrim dore, ku pasqyrohej shkurt dorëzimi e marrja e turneve përkatëse, datat, emri e mbiemri i dorëzuesit, emri e mbiemri i marrësit të shërbimit, dhe nënshkrimet përkatëse.

Sipas ankuesit, punëdhënësi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit, 1 (një) muaj para se të mbushte moshën për pension. Kishte për të dalë në pension në datën 24.07.2021, por ka punuar deri më datë 08.07.2021, e më pas punëdhënësi pa dëshirën e tij, i ka dhënë 16 ditë leje të zakonshme për pjesën tjetër.

Në momentin e daljes në pension, ankuesi pretendon se nga ana e punëdhënësit nuk i është dhënë shpërblimi i parashikuar në legjislacionin përkatës.

Ai pretendon se çdo muaj ka bërë 240 orë pune, (nga 160 orë që duhet të bënte normalisht, sipas legjislacionit). Për çdo muaj ka bërë 15 ditë roje, turni i 3-të, për të cilat nuk është paguar vështirësia shtesë prej jo më pak se 50% shtesë mbi pagë, (pra nga ora 22:00 deri në orën 06:00 të mëngjesit), referuar Kodit të Punës. Ndërsa, për intervalin e punës nga ora 19:00 deri në 22:00, nuk është paguar vështirësia me të paktën 20% shtesë mbi pagë.

Në këto kushte, ankuesi J. Z., sqaron se i është drejtuar me shkresë Bashkisë Tiranë, në 2 (dy) raste, duke kërkuar informacion dhe dokumente, lidhur me marrëdhëniet e punësimit që ka patur me të.

Sa më sipër, sipas tij, Bashkia Tiranë ka kryer një sërë shkeljesh ligjore dhe veprime diskriminuese, duke shkelur hapur dhe kontratën e punës, që vetë ajo ka hartuar dhe firmosur. Ankuesi J. Z., pretendon se diskriminimi i tij nga ana e Bashkisë Tiranë, ka ndodhur në disa forma: atë drejtpërdrejtë, ndërsektorial, të shumëfishtë, strukturor dhe në formën e diskriminimit të rëndë, sepse është diskriminimi, sipas tij, është kryer më shumë se një herë, si dhe ka zgjatur për një kohë shumë të gjatë.

Në përfundim, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit ndaj tij, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore, moshës, gjendjes shëndetësore dhe çdo shkak tjetër.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në informacionin e dërguar me anë të e-mail-it datë 21.09.2023, subjekti ankues⁴ ka bashkëlidhur dhe kopje të dokumentacionit poshtëcitur:

- Kërkesë Padi kundër Bashkisë Tiranë, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: “
 1. Konstatimin e moszbatimit në mënyrë të rregullt të kontratës individuale të punës të datës 04.03.2013, nga ana e Bashkisë Tiranë me punëmarrësin J. Z.;
 2. Konstatimin e diskriminimit të punëmarrësit J. Z. gjatë marrëdhënies së punës me Bashkinë Tiranë...”.

⁴ Përmes e-mail-it të Avokatit L. Z.

Referuar bazës ligjore të cituar në kërkesë padi, J. Z., ka cituar: “

- Neni 9 i Kodit të Punës, “Ndalimi i Diskriminimit;
- Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar...”.

Në nenin 9/6 “Ndalimi i diskriminimit”, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “6. Në zbatim të parimit për trajtim të barabartë, të gjithë punëmarrësit dhe çdo grup punëmarrësish duhet të trajtohen me të njëjtin respekt dhe kujdes dhe duhet të respektohen edhe rrethanat e tyre të veçanta.”

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të depozituar si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues, për diskriminim, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe përpara Komisionerit, janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para Gjykatës, nga ana e ankuesit.

Në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të pushonte çështjen nëse ajo do të ishte në shqyrtim e sipër. Pra, jemi në kushtet kur ankesa e paraqitur, është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

Bazuar në nenin 36/4, të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁵, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

⁵ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 168 Regj., datë 14.09.2023, të paraqitur nga shtetasi J. Z., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: gjendja ekonomike, arsimore, shoqërore, mosha, gjendja shëndetësore dhe çdo shkak tjetër)
(Fusha: Punësim)